



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 285/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Muhamet Rexha, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, për shkak të mos-përputhjes së rezultateve preliminare të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ) në seancën e panelit të mbajtur me 24.11.2010, mori këtë:

V E N D I M

MIRATOHET si e bazuar ankesa e subjektit politik AAK.

URDHËROHET KQZ që të numëroj fletëvotimet në Qendrat e Votimit (QV) 1612/a – Vendvotimi (VV) 03/R; QV 1603/a – VV 01/R; QV 1623/a – VV 01R dhe ky numërim të përfshihet në rezultatin preliminar të Zgjedhjeve të Jashtëzakonshme në Komunën e Rahovecit.

A R S Y E T I M

Subjekti politik AAK, dega në Rahovec, ka parashtruar ankesë më të cilën pretendon se kandidati për kryetar i këtij subjekti politik z. Smajl Latifi, është dëmtuar për 457 vota. Po ashtu, sipas pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ekziston një mos-përputhje e rezultateve në mes të rezultateve preliminare të shpallura nga KQZ-ja dhe gjendjes faktike të argumentuara në formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve të nënshkruara nga komisionarët e të gjitha partive politike. Parashtruesi i ankesës pretendon se kandidati i lartë përmendur në QV 1612/a –VV 03/R është dëmtuar për 200 vota, QV 1603/a – VV 01/R është dëmtuar për 137 vota dhe QV 1623/a – VV 01R është dëmtuar për 120 vota dhe për këto arsye ka propozuar që të aprovohet ankesa.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat tjera të lëndës e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

- **ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se në publikimin e rezultatit preliminar nga KQZ, nuk është përfshirë numri i fletëvotimeve në 3 (tri) vendvotimet të theksuara si në dispozitiv. Paneli vlerëson se këto veprime përfaqësojnë padrejtësi serioze e në bazë të nenit 119 paragrafi 5 i LZP-së,

Nga këto arsye e më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura është vendosur si në dispozitiv në bazë të nenit 115.1 e lidhur më nenin 119.5 të LZP-së, për shkak se në dispozitën e nenit 119.5 të LZP-së parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 285/2010 më datën 24.11.2010.

Kryesuesi i Panelit

